



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. _____ Prot.

Pogradec më 13.02.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Mbikqyrje e objektit “Loti IV, Ura e Zëmçës - Kryqëzimi,
Proptisht, Bishnice”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

71247000-1 (Mbikëqyrja e punës së ndërtimit)

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 816 549, 15 (nje milion e teteqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e peseqind e dyzet e nente presje pesëmbëdhjetë) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Pogradec** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë *vërtetim të xhiros vjetore të lëshuar nga administrata tatimore për vitet 2020, 2021 dhe 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2020 - 2021- 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit . Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur, nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.2 Kandidati/ofertuesi duhet të përcaktojë stafin teknik të shoqërisë në përberje të saj, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Topograf 1 (një)

-Për inxhinieret e mesiperm, operatori ekonomik duhet të paraqese:

- -Kontrate pune
- -Diplome dhe të jene të pasqyruar në listepagesat e shoqërisë për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

*Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, ofertuesi i kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”*

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, Vendimin Nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Licencimin Profesional Të Individëve Dhe Personave Juridikë Që Do Të Ushtrjnë Veprimtari Në Fushën E Studimit E Të Projektimit Në Ndërtim Dhe Mbikëqyrjes E Kolaudimit Të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim” i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri për stafin është bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit te zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur per zbatimin e kesaj kontrate.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikëqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.

2.3.3 Cdo operator ekonomik ofertues duhet të paraqese licensen profesionale te shoqerise per mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi, ku te perfshihen kategorite e meposhtme:

- NP 1 Punime germimi ne toke
- NP4 Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- NP 5 Punime nentokesore, ura e vepra arti
- N.S 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore
- N.S 18 Punime topogjeodezike

Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjës;

Shenim: Në përgatitjen e ofertes, ofertuesit duhet të respektojnë Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manulit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik(APP) me shkresen me Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017,” Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave” me qellim respektimin nga operatorët ekonomikë të normave minimale (vlerave minimale të lejuara), të specifikuara në këtë vendim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM nr.759 date 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategorite e kerkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve që do realizohen sipas preventivit dhe projektit të zbatimit. Kërkesa e disponimit të një license të tilla të leshuar nga ana e organeve kompetente është e lidhur ngushtesisht me tipologjinë e shërbimit të kërkuar objekt kontrate si dhe elementeve të zerave të preventivit , ku janë zera të cilët janë të pasqyruar në VKM nr 629 date 15.07.2015 ”Per Miratimin e Manualeve Teknike të Cmimeve të Ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike të përfshira në termat e referencës janë hartuar në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Perlllogaritja e fondit limit është bërë nga Specialisti I Fushës së D.P.K.ZH.T..

NJESIA E PROKURIMIT: